

[Data 09/10/2023]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rritja e kapaciteteve TIK të infrastrukturës qendrore (datacenter) dhe rritja e kapaciteteve për përdoruesit fundorë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje kompjuterike dhe furnizime 30200000-1 2. Servera 48820000-2 3. Kujtesa ram 30236110-6 4. Njësia qendrore e përpunimit (cpu) ose procesorë 30211500-6 5. Kompjuter desktop 30213300-8 6. workstation 30214000-2 7. Pajisjet e rrjetit 32420000-3 8. Sisteme operative 48620000-0.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 66,555,937 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, ose 630,862 (gjashtëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro

Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është: 17.409.636 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, ose 165,020.25 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëzet pikë njëzet e pesë) Euro (ku fondi limit nënkupton totalin e çmimeve të përlogaritura për njësi për çdo artikull (thënë ndryshe shumatorja e çmimeve për njësi).**

* **Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 09/10/2023 është 105.50 Lekë/Euro**

Sqarim: Referuar nenit 62 pika 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi dhe për efekt krahasimi edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores të çmimeve për njësi të përlogaritura për çdo artikull. Klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër do të bëhet sipas vlerës më të ulët, të shumatores të çmimeve për njësi për çdo artikull.

Shënim: Referuar sasive orientuese të përcaktuara në shtojcën Nr. 6 “Formulari i sasisë orientuese dhe grafikut të lëvrimit”, operatorët ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë se nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit/ vlerën e pritshme të kontratave, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion me anë të V.K.B-së Nr. 126 dt 23.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023”, i ndryshuar.

Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë: Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: **3 (tre)**. Në rast të kundërt, autoriteti kontraktor mund të lidh marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy.

Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

- Do të ketë rihapje të konkursit.
- Bashkia Tirane do të përgatitë një ftesë për ofertë dhe do t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik.
- Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë do të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.
- Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe të Dhënave në mënyre periodike do të evidentojë kërkesat/nevojat për artikujt e kërkuar si dhe afatin e lëvrimit të tyre. Procesi i mini konkurrencës për lidhjen e kontratës do të zhvillohet sa herë që institucioni Bashkia Tirane do të ketë nevojë për lëvrimin e artikujve pjesë përbërëse e preventivit objektivit prokurimi.
- Kriteri i vleresimit në rastin e rihapjes së konkurimit për lidhjen e kontratës do të jetë: Çmimi më i ulët i ofertës, por në çdo rast ofertuesit nuk duhet të tejkalojnë vlerën e ofruar të deklaruar në ofertat e shpallura fituese.
- Kontratat do të lidhen sa herë që Autoriteti Kontraktor do të ketë nevojë brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër deri në ezaurimin e plotë të fondit limit/ vlera e pritshme e të gjitha kontratave sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës/ Marrëveshjes Kuadër “

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: ose afati i zbatimit të kontratës: Afati kohor i parashikuar për realizimin e objektit të prokurimit është 24 (njëzet e katër) muaj. Data e fillimit të implementimit të kontratës/kontratave është data e nënshkrimit dhe perioda e parashikuar për realizimin e saj/tyre është 1 (një) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Përgjatë periudhës një mujore të realizimit të kontratës/kontratave lëvrimi i pajisjeve do të realizohet sipas kërkesave të AK.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Pranë Magazinës së Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të artikujve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë malli duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues pas procesit të minikonkursit, pasi furnizimi i artikujve nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e furnizimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të furnizimit me pajisje teknologjike për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve TIK për përdoruesit, si dhe kosto shtesë për AK.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e pajisjeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin në kohë, për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve TIK për përdoruesit, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe

miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet përkatësisht 133.111.874 (njëqind e tridhjetë e tre milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH lekë. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Kjo procedurë është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022), të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të pritshme të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi në përputhje me dispozitat ligjore.*

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standartin ISO 20000-1 (ose ekuivalente) për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi 2.3.2 dhe 2.3.3

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar),

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 ose ekuivalente është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të furnizimit, instalimit dhe

konfigurimet e nevojshme të pajisjeve të infrastrukturës core dhe të rrjetit (server, storage, switch, si dhe komponentët shoqërues) sipas nevojave të AK, bazuar në specifikimet teknike përgjatë afatit të zbatimit të kontratës sipas kërkesave të DST-së.

Kjo certifikatë ose ekuivalente e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha furnizimet, instalimet dhe konfigurimet që do të realizohen përgjatë kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të teknologjisë së informacionit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Distributori të autorizuar për pajisjet e ofertuara :

- Kompjuter Desktop 1 Tipi 1
- Kompjuter Desktop 1 Tipi 2
- Kompjuter Desktop 2
- UPS
- Workstation Tipi 1
- Laptop Tipi 1
- Laptop Tipi 2
- Licenca për socket VMware për vSphere 7
- Upgrade i sistemit VDI (Thin client, VMware Horizon)
- Switch i menaxhueshëm 48 porta
- Switch i menaxhueshëm 48 porta
- Switch L3 24 porta
- Switch L2 48 porta
- Switch FC 24 porta
- Server Tipi 1
- Server Tipi 2
- Platformë Appliance Virtuale

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, këto të nevojshme për AK në rast verifikimi.

Argumentimi: Referuar nenit 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Duke qenë se Autoriteti kontraktor, është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të

paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për komponentë të rëndësishëm dhe thelbësorë të kontratës, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmimeve nga prodhuesi/ distributori i autorizuar për zërat e kërkuar sipas kriterit, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të pajisjeve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike në të cilën duhet të përcaktohet marka, modeli shoqëruar me katalogë ose broshura për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST.

Në ofertën teknike gjithashtu duhet të jepet informacion i detajuar me të gjithë numrat e pjesëve të të gjithë komponentëve dhe sasi të tyre të konfigurimit të propozuar sipas zërave të kërkuar në dokumentin e specifikimeve teknike (aty ku është kërkuar).

(Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të software duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumenti: Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 6/b, i cili përcakton se :

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

...b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose”...

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.

2.3.6 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, për të realizuar instalimet dhe konfigurimet e kërkuara si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë minimalisht 2 (dy) punonjës të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për virtualizim.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për instalim, konfigurim Serveri

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër)/ profilin (certifikimet) e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4 .

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

....”

- **Argumentimi i kriterit: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për virtualizim.**

Kërkesa e autoritetit kontraktor për “Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për virtualizim” është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me zërat e kërkuar objekt prokurimi si më poshtë” :

1. Licenca për socket VMware për vSphere 7
2. F.V Upgrade i sistemit VDI
3. F.V VMware Horizon 8 Adv

Bazuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, Bashkia Tiranë ka të Instaluar në infrastrukturën e saj platformën e virtualizimit vCenter Standard Versioni 7 nëpërmjet të cilës menaxhon makinat virtuale VMware vSphere 7. Nëpërmjet kësaj kontratë kërkohet të realizohet furnizimi, instalimi, konfigurimi i licensave për socket VMware vSphere 7, sipas nevojave të AK si dhe mbështetje 3 (tre vjet) nga prodhuesi. Gjithashtu pjesë e kësaj kontratë është realizimi upgrade i sistemit VDI i cili gjithashtu është një sistem që ngrihet mbi platformë virtuale (VMware Horizon 8 ADV).

Për sa më sipër, për të garantuar Autoritetin Kontraktor së operatori ekonomik ka aftësitë e nevojshme teknike për realizimin e zëravë të sipërcituar, është e nevojshme dhe e domosdoshme prania e të paktën një punonjësi të certifikuar për virtualizim, i cili gjithashtu dëshmon dhe garanton suportin përgjatë periudhës së garancisë.

- **Argumentimi i kriterit: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për instalim, konfigurim Serveri.**

Kërkesa e autoritetit kontraktor për “Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për instalim, konfigurim Serveri” është e bazuar dhe e lidhur me zërat objekt kontrate si më poshtë:

1. F.V Server Tipi 1
2. F.V Server Tipi 2
3. 32 GB RAM DDR4 për server Fujitsu Primergy RX2530M4
4. 32 GB RAM DDR4 për server Fujitsu Primergy RX 2530 M5
5. Procesor për server Fujitsu Primergy RX 2530 M5, 16 core 32 thread
6. Blerje garancie për server Fujitsu RX2530M5

Nëpërmjet kësaj kontrate kërkohet të realizohet “Furnizim, instalim dhe konfigurimet e nevojshme të pajisjeve (server..., etj, si dhe komponentët shoqërues) sipas nevojave të AK, bazuar në termat e referencës dhe specifikimet teknike.

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për instalim, konfigurim serveri, shërben si garanci për realizimin e instalimeve dhe konfigurimeve në infrastrukturën ekzistuese në institucion të serverave të rinj si dhe realizimit të konfigurimeve që do të nevojiten për optimizimin e serverave ekzistues. Gjithashtu pjesë e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për këto zëra përfshin garancinë. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor shërben gjithashtu për të garantuar shërbimin e suportit mbi pajisjet përgjatë periudhës së garancisë si dhe për realizimin me sukses dhe në kohë të kontratës në tërësi.

Sa më sipër cituar, kërkesa e autoritetit kontraktor, është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me natyrën dhe objektin e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentim i termave të referencës:

Qëllimi kryesor i kësaj kontrate është furnizimi me pajisje teknologjike si (workstation, kompjuter, laptop, upgrade i sistemit VDI, switch, storage, kasete për tape library, server, dhe komponentët e nevojshëm për funksionimin e tyre), për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbimeve TIK për përdoruesit.

Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori janë:

- Furnizim, instalim dhe konfigurimet e nevojshme të pajisjeve të infrastrukturës core dhe të rrjetit (server, storage, switch, kasete për tape library si dhe komponentët shoqërues) sipas nevojave të AK, bazuar në specifikimet teknike të hartuara në këtë dokument.
- Furnizimi, i pajisjeve për përdoruesit fundorë, kompjuter, VDI, workstation, laptopë, ekran digjital outdoor si dhe realizimi i shërbimeve të lidhura me to, aty ku kërkohet, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.
- Integrimi i infrastrukturës së re me Infrastrukturën ekzistuese në Institucion.
- Testimi i pajisjeve.
- Marrja në dorëzim.

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor.

1. KOMPJUTER DESKTOP 1 TIPI 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	6700 pikë
“RAM”:	8 GB GB DDR4, min. 3200 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	256 GB SSD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
	M2 slot
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	

Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP, (1) Portë HDMI
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 11 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Këta kompjutera do të jenë për përdorim masiv nga stafi, duke përdorur aplikacionet standarde për të cilat nuk ka nevojë për një procesor shumë të shpejtë.

Aplikacionet e gjeneratës së sotme kërkojnë minimalisht RAM 8 GB. Eshtë kërkuar SSD për shpejtësi më të madhe dhe procesim më të shpejtë të të dhënave. Meqënëse përdoruesit do të përdorin dokumente të Word apo Excel e programe të ngjashme me to, nuk ka nevojë për shumë storage.

Kërkohej që kompjuteri të ketë një grafike minimaliste prej min 1 GB.

Janë kërkuar 6 porta USB për të lidhur pajisje të ndryshme periferike si mouse, tastiere, flash drive etj.

2. KOMPJUTER DESKTOP 1 TIPI 2 MINIPC

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	12000 pikë
“RAM”:	8 GB GB DDR4, min. 3200 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	256 GB SSD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
	M2 slot
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP, (1) Portë HDMI
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 11 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit “Contrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Këta kompjutera do të jenë për përdorim më specifik, duke përdorur aplikacionet standarde për të cilat kanë nevojë për një procesor më të shpejtë, pasi përdoruesit e tyre kanë disa detyra specifike dhe duhet të punojnë me disa programe njëkohësisht.

Aplikacionet e ditëve të sotme kërkojnë minimalisht 8 GB RAM. Eshtë kërkuar SSD për shpejtësi më të madhe.

Kërkohej që kompjuteri të ketë një grafikë minimaliste prej min 1 GB.

Janë kërkuar 6 porta USB për të lidhur pajisje të ndryshme periferike si mouse, tastierë, flash drive etj.

3. KOMPJUTER DESKTOP 2

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	17500 Pikë
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 3200 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	256 GB SSD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor)
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (2) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
